



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VORE

Data: ___/___/2022

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

Mbikqyrje per objektin “Rindërtimi i Shkollës së Mesme “ Isa Boletini”, Vorë”:

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT

Kodi CPV: 71247000-1 - Mbikëqyrja e punës së ndërtimi

VLERA E FONDIT LIMIT: 2 939 621,14 (dy milion e nentëqind e tridhjetë e nente mijë e gjashtëqind e njetzet e një presje katermbedhjetë) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Vore ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, si dhe në nenin 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2019, 2020 dhe 2021** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të kësaj procedure.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43, pika 2, gërma c) e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit "Shërbim konsulence".

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

2.2.2 . Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2019, 2020 dhe 2021** të konfirmuara nga administrata tatimore, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 9, të Ligjit Nr.25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 .Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të maturuara të taksave dhe tarifave vendore të vitit 2022, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenin 43, nenin 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" i ndryshuar, nën 3.1/a, b, c dhe nën 40, në ligjin nr.131/2015 "Per QKB" i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 "Per QKR" i ndryshuar.

Meqenese operatoret ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi **për shërbime** të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se **20 % të vlerës** së fondit të limit të përlllogaritur të kontratës që prokurrohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik **për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shenohen vlera, afati i perfundimit të kontratës ose/dhe faturave**

tatimore te shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sherbimet e realizuara.

- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si deshmi pranohen vetem fatura tatimore të shitjes **të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara ne organet tatimore,** ku shënohen datat, shumat dhe sherbimet e realizuara.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 40, pika 4 si dhe neni 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përvoja e mëparshme është element shumë i rëndësishëm që garanton autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së sherbimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses.*

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë profesionale të vlefshme për mbikqyrjen dhe kolaudim te punimeve objekt i kontrates, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë , e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Licencë profesionale të shoqërisë për supervizion punimesh te vlefshme, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore, për kategoritë si më poshtë ose ekuivalente te tyre:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

- NP-1 Punime gjërmimi në tokë;
- NP-2 Ndërtime civile dhe industriale;
- NP-12 Punime te inxhinierise se Mjedisit;

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

- NS-2 Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;
- NS-4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese;
- NS-12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit ;
- NS-14 Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV;
- NS-18 Punime topogjeodezike.

Licensa duhet te jete leshuar sipas rregullave te VKM nr 759 date 12.11.2014 “Per licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” i ndryshuar me VKM nr 943 date 28.12.2016. Shoqëritë e huaja, në lidhje me ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës, të zbatojnë legjislacionin shqiptar në fuqi.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin Nr. 943, Datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”.

AK-ja në përcaktimin e kategorive të licencës së kërkuar në këtë procedurë prokurimi merr në konsideratë Ligjin Nr. 8402, date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar, pasi në përzgjedhjen e kategorive dhe klasave të licencës, duhet qe licencat e mbikqyrësit janë të njëjta me ato të ndërtuesit.

2.3.3 Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të ketë ne stafin e tij inxhinier te licensuar per kategorite e kerkuara, të vërtetuar me Licence profesionale te shoqerise ose Licences individuale, CV, kontratë pune të vlefshme, diploma si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Inxhinier Gjeolog

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

Për secilin pjestar te stafit inxhinierik te mesiperm duhet te paraqese, Kontrate pune e vlefshme, diplome , Libreze pune .

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.4 Një punësim mesatar i të paktën 6 (gjashte) personave, për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, të vërtetuar me;

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri I punonjësve për secilin muaj, për periudhën *e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave*.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën *e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave*.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë: **per përcaktimin e fuqisë punëtore minimale të kërkuar argumentojme se jemi bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Stafit inxhinierik** për zbatimin e kësaj kontrate. *Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.*

2.3.5 Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 9001-2015 (e vlefshme). lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim me objekt: supervizion rrugësh dhe ndërtesa civile. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

2.3.6 Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 14001-2015 (e vlefshme). lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim me objekt: supervizion rrugësh dhe ndërtesa civile. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 45001-2018 (e vlefshme) lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim me objekt: supervizion rrugësh dhe ndërtesa civile. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

Argumentimi: *Kërkesat e mesiperme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose*

shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”

Çertifikatat e cilësisë janë bazuar në përputhje me objektin e zbatimit që do të mbikqyret dhe janë në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet.

2.3.8 Operatoret ekonomike në përgatitjen e ofertës së tyre duhet të referohen VKM nr.354, datë 11.05.2016”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, si dhe në mbështetje të udhëzimit të Agjencisë Prokurimit Publik datë 25.07.2017, prot 5585 ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.354, datë 11.05.2016” *“Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”*

Argumentimi: Në bazë të udhëzimit të Agjencisë Prokurimit Publik datë 25.07.2017, prot 5585 ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.354, datë 11.05.2016” *“Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”* me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin ofertat e tyre në bazë të tarifave minimale të llogaritura sipas VKM nr.354 për realizimin me sukses të kontratës së objektit: ***Mbikëqyrje të punimeve për objektin “Rindertimi I Shkolles së mesme Isa Boletini” Bashkia Vore,***

Shenim: Në përgatitjen e ofertës, ofertuesit duhet të respektojnë Vendimin nr.354, datë 11.05.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” dhe Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) me shkresën me Nr. 5585 Prot., datë 25.07.2017,” Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin nr.354, datë 11.05.2016, të Këshillit të Ministrave” me qëllim respektimin nga operatorët ekonomikë të normave minimale (vlerave minimale të lejuara), të specifikuara në këtë vendim. Për vlerën e fondit limit referohuni buletinit të APP për procedurën punë për objektin në fjalë. Në rast se oferta është me e ulët se minimumi i përcaktuar në këtë vendim ajo do të skualifikohet.

Në rastet e bashkimit të konsulentëve, kriteret e veçanta të kualifikimit plotësohen bashkarisht nga i gjithë bashkimi.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

